



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

Nr. _____ Prot.

Berat, më __22 /_08_/2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontrates - PUNE

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT : "NDERHYRJE REHABILITUESE NE MURE MBAJTESE DHE
TERRENE NE TERRITORIN E BASHKISE NE KUADER TE MBROJTJES CIVILE"

1. **VLERA E FONDIT LIMIT :** 7 747 353.40 (shtate milion e shtateqind e dyzete e shtate mijë e treqind e pesedhjetë e tre presje dyzete) leke pa Tvsh, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit

Monedha, pa TVSH.

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", nenin 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentim:kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika1/a dhe 2, ne LPP. nenin 39 pika 6/p te VKM,nr285, date 12.05..2021, "Per miratimi e rregullave te prokurimit publik ".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

2.2.1 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat". i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, behet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm :** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh, ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh, iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin e fundit (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së fondit të limit të lotit/shumës së loteve për të cilët konkuron dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të lotit/shumës së loteve të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruara në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorë të nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruara në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;

2.3.1 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

2.3.2/a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

NP -1A - Punime germimi në tokë

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NS-1A -Punime për prishjen e ndertimeve.

NS-8 A - Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensa profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkengjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.S - 1 A	-Punime prishjen ndertimeve.	Germim dheu	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
NS-1A	-Punime prishjen ndertimeve.	Punime prishje	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

N. S -8 A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
-----------	---	--	---	---

Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

- a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë - 1 (një) Inxhinier topograf /Gjeodet me kontrate pune ose kontrate bashkepunimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare dhe Cv.
Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i ndertimit** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te punimevete objektit qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve ndertimore referuar preventivit.
- **Inxhinieri Topograf/ Gjeodet** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te kuotave te projektit objekt prokurimi.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- | | |
|----------------------------|-----------|
| • Punonjës teknik ndërtimi | 1 (një) |
| • Saldator | 3 (tre) |
| • Karpentier | 3(tre) |
| • Puntor lartesisë | 4 (kater) |
| • Hekurkthyes | 2(dy) |
| • Murator | 3(tre) |

- Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :
- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e pikës 2.3.6, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- Tekniku i ndertimit eshte i nevojshem per ndjekjen e realizimin te punimeve te



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

- ndertimit, sipas zerave te preventivit.
- Saldatori eshte i nevojshem per saldimin dhe montimin e pjeseve te parapregatitura beton arme.
 - Karpentieri jane te nevojshem gjate gjithë periudhes se realizimit te punimeve per punime te ndryshme ne kantier.
 - Punetoret e lartesisë jane te nevojshem per kalloposjen e murit ne lartesi dhe punimet qe do te kryhen kerkojne njerez te trajnuar per punime ne lartesi.
 - Hekurkthyesit Jane te domozdoshem ne objekt per punimin edhe lidhjen e hekurit te murit.
 - Murator Jane te nevojshem per ndertimin e murit te gurit mbajtes.
 - Shofer per drejtimin e mjeteve te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.
 - Manovrator per drejtimin e mjeteve te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.

Numri i punetoreve te siperpermendur eshte vendosur sipas zberthimi te zerave te preventivit dhe volumeve perkatese ku:

Bazuar ne preventivin dhe grafikun e punimve nr total i punetoreve per realizimin e kesaj pune

N r	PUNIMET	ORE PUNE	DITE PUNE	PUNTORE/6mua j
	PERMBLEDHJE PUNTORE/6 MUAJ	19000	132	18

- c) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

d) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Shofer 1(nje)
- Manovrator 1(nje)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdherin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore, shofer dhe staf kryesor prej minimalisht 20(njezete) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për muajin e fundit.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Nr i punonjësve qe nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

	Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
	1	Kamiona vetshkarkues , kapaciteti mbajtës jo me pak se 18 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
	2	Kamion me vinc	në pronësi ose me qera	cope	1
	3	Eskavator me zinxhire	në pronësi ose me qera	copë	1
	4	Kamiocine	në pronësi ose me qera	copë	1
	5	Betonier Kantieri	në pronësi ose me qera	copë	1
	6	Skeleri	në pronësi ose me qera	M2	200
	7	Matrapik per thyerje betoni	Ne pronesi ose me qera	cope	1
	8	Saldatrice	Ne pronesi ose me qera	cope	1
	9	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qera	cope	1

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 20 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 6 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 10 copë
- Prozhektor ndricimi naten – jo më pak se 6 copë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

- **Kamiona vetshkarkues** duhen per transportin e dherave ne objekt dhe materialeve te ndryshme.
- **Kamion me vinc** eshte i nevojshem per transportin dhe shkarkimin e materialeve hekur, cimento ne nje kohe sa me te shkurter.
- **Eskavator me zinxhire** eshte i nevojshem per sistemimin dhe hapjen e vendit ku do te kryhet punimet.
- Kamiocina** eshte e nevojshme per transportin e materialeve brenda kantierit .
- Betoniere kantieri** eshte e domozdoshme per punime betoni ne Objekt sipas zerave te preventivit.
- Skeleri** eshte e nevojshme per punimet ne lartesi.
- **Tabelat sinjalistike** jane te nevojshme per sinjalistikene ne objekt.
- **Komplet i ndihmes se shpejt** eshte mjaft i nevojshem per tu dhene ndihmen e shpejte punonjesve dhe manovratoreve ne objekt ne rast aksidentesh.
- Matrapik per thyerje betoni.** eshte i domozdoshem per tyerjen e elementeve beton arme.
- Vibrator betoni** eshte i domozdoshem per vibrimin dhe ngjeshjen e betonit.
- Saldatrice** eshte e domozdoshme per saldimin,drejtimin ,bashkimin e detajeve te ndryshem me bashkimin e objekteve te madhesive dhe formave te ndryshme duke perdorue mjetet dhe pajisjes e duhura.
- Prozhektori** eshte e domozdoshme per ndricim naten.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e meposhtëm :

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.

e) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës.
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë si dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (ose ekuivalente)

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor (ose ekuivalente)

ISO 45001:2018 ose standardin e përditësuar (ISO 45001-2023) Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (ose ekuivalente)

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001:2015 është ne seri normash dhe standartizimesh ndërkombetare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

private, struktura te cilat keto nderrmarje duhet t'i adoptone per nje orientim me te mire te nderrmarjes ne standartet e tregut. AK gjykon se cdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 9001:2015 ose ekuivalente me qellim efektivitetin dhe efektshmerine ne zhvillimin e veprimtarise se tij, e cila do te sjelle dhe zvogelimin e kostove. Pra ky certifikim do te beje te mundur qe Ofertuesit te ofrojne cilesi te mire me cmime te ulta.

ISO 14001:2015 ofron nne kuader praktik per shoqerite qe duan te menaxhojne rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtesisht ne strukturen e menaxhimit te biznesit per te kontrolluar impaktet qe aktivitetet, operacionet, produktet dhe sherbimet kane mbi mjedisin. AK gjykon se qdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 14001:2015 ose ekuivalente me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana tij (ne rastin konkret realizimi i punes objekt prokurimi) te identifikojë impaktin ne mjedis gjate aktivitetit te saj si dhe te permiresoje performancen mjedisore duke zbatuar nje qasje sistematike. Pra ky certifikim do te beje te mundur qe Ofertuesit te ushtrojne veprimtarine duke pasur ne konsiderate parimin e mbrojtjes se mjedisit.

ISO 45001-2018 / (ISO 45001-2023 eshte standard nderkombetare, i cili parashtrohet per menaxhimin e praktikave te mira te sigurise dhe shendetit ne pune per cdo organizate, pavaresisht nga madhesia. AK gjykon se cdo Ofertues duhet te jete i pajisur me ISO 45001-2018/(ISO 45001-2023 ose ekuivalente me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana tij (ne rastin konkret realizimi i punes objekt prokurimi) te realizohet duke u mbeshetur mbi parimin e sigurise dhe shendetit ne pune. Kjo kerkese sherben dhe si nje garanci extra qe do te sjelle reduktimin e aksidenteve dhe semundjeve ne vendin e punes duke minimizuar kostot si dhe kohen ne permbushje me sukses te kontrates se punes objekt

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit jane hartuar nga projektuesi dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për Informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në Ndërtim

Në specifikimet teknike, ne rastet kur eshte permendur një markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, do te pranohen ose ekuivalente”.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

*do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*